Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0039

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani-Kryetar,duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Agri Bau Sh.P.K." kundër Vendimin për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit të Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi Sh.A." me nr. të prokurimit: "NPLP-23-13818-1-2-1", me,30/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Agri Bau Sh.P.K" me nr. 2024/39, e datës 03/01/2024, kundër vendimit të AK- Ndërmarrja Publike Lokale Përparimi SH.A, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi sh.a." me nr. të prokurimit: "NPLP-23-13818-1-2-1".

2.Mbetët në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues "i datës, 29.12.2023, i AK-Ndërmarrja Publike Lokale Përparimi SH.A- Qyteti Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit si në pikën një (1) të dipozitivit të këtij vendimi.

3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik "Agri Bau Sh.P.K", sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 11.12.2023, Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi Sh.A." me nr. të prokurimit: "NPLP-23-13818-1-2-1" .Ndërsa

me datën 29.12.2023. ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë "Lulishtja Buqaj".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 85,000.00 euro.

Me 03.01.2024, OE "Agri Bau Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Agri Bau Sh.P.K." me nr. 39/2024 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi Sh.A." me nr. të prokurimit: "NPLP-23-13818-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Agri Bau Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon se : Me datën 03.01.2024 kemi bere kërkesë për Rishqyrtim te Vendimit te datës 29.12.2023 për aktivitetin e prokurimit Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi sh.a. nr. prokurimi 4NPLP-23-13818-1-2-1 ku me këtë vendim është shpërblyer me kontrate OE N. T.P. Lulishtja Buçaj, në vlere prej 80,000.00 €dhe është eliminuar kompania jone OE AGRIBAU" SHPK e cila kishte ofertën ne vlere prej 73,300.00 €. Ky aktivitet i prokurimit është përcjellë me shkelje ligjore qe nga Njoftimi për kontrate ku janë caktuar afate qëllimisht te shkurtër, specifikime te pa paqarta. mos sqarime nga ana e AK-se ne kërkesën për sqarime, ndryshime ne dosje dhe paramase mirëpo mos shtyrje te afatit te dorëzimit te ofertës si psh: Njoftimi për kontrate 12.12.2023, Afati për Kërkesa për sqarim te DT-se 15.12.2023 (dite e Premte), -Ndryshimi ne dosje te tenderit dhe paramase 18.12.2023 ora 20:43. -Ndryshim tek Përshkrimi te çmimit 18.12.2024 ora 20:44. Afati për dorëzim 22.12.2023. Me datën 15.12.2023 (brenda afatit ligjor) ne kemi bere kërkesë për sqarime te DT-se lidhur me specifikimet e kërkuara nga ana e AK-se ku ishin specifikime te pa qarta për shkak se ne përshkrim kërkohej Kamion për debllokim te kanalizimeve ndërsa ne specifika kishte kërkese për kamion te mbeturinave, po ashtu brenda atyre specifikave kishte kërkesa për gypa me presion te ujit qe nënkuptonte se po kërkohet cisterne për pastrim te rrugëve, dhe për ketë shkak ne kemi bere kërkesë për sqarime se çfarë kamioni janë duke kërkuar (shih kërkesën për informacione shtese qe do ti bashkëngjitet kësaj ankese). Me datën 18.12.2023 rreth orës 20:43 AK përmes E-prokurimit ka bere ndryshime ne dosje te Tenderit tek specifikimet teknike dhe Paramasa mirëpo nuk ka bere shtyrje te afatit për dorëzim te ofertave ashtu siç kërkohet me ligjin mbi prokurimin publik Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit paragrafi 7. ku thuhet; 7 Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtë se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë. Me ketë veprim te qëllimshëm AK na ka eliminuar nga mundësia e kërkesës për Rishqyrtim, qëllimshëm ishte edhe afati për sqarime te DT-se data 15.12.2023 (dite e Premte) ku dita e

hënë ishte date 18.12.2023 dhe nuk kishte mundësi për kërkesë për Rishqyrtim pasi qe ishin me pak se 5 dite nga data e ofertës dhe për këtë shkak nuk ka bere shtyrje te afatit te ofertave. Me datën 19.12.2023 përmes email zyrtare te AK qe është ne dosje te tenderit, kemi para lajmëruar dhe kërkuar nga AK se nuk kanë dhënë përgjigje ne kërkesën për sqarime, se kanë bere ndryshime ne DT dhe nuk kanë vazhduar afatin e dorëzimit te ofertave mirëpo prap AK nuk ka reaguar (në ankesë është bashkangjitur email). Pas gjithë këtyre kërkesave qe ne kemi paraqitur tek AK ne kemi qene ne pritje se Autoriteti Kontraktues do te reagoj dhe do te beje shtyrjen e afatit te dorëzimit te ofertave ashtu siç parashihet me ligj. Mirëpo me datën 22.12.2023 kemi vërejtur se nuk ka përgjigje nga ana e AK-se dhe nen presionin e kohës ne kemi përgatitur Ofertën për dorëzim ku edhe kemi dorëzuar ofertën, mirëpo gjate ngarkimit te lendes ka ndodhur gabim teknik ne ngarkimin e Certifikatave ISO. Se ky aktivitet është tërësisht i orientuar ne një Ofertues te vetëm tregon fakti se AK për blerjen e kamionit për mbeturina ka kërkuar certifikata ISO te dedikuara për lulishte, (shih kërkesën ne dosjen e tenderit). Me datën 29.12.2023 AK merr vendim për te eliminuar kompaninë OE "AGRIBAU" SHPK e cila kishte ofertën ne vlere prej 73,300.00 €dhe shpërblen me kontrate OE N.T.P. Lulishtja Buçaj në vlere prej 80,000.00 €me arsyetimin: 1. Nuk keni plotësuar formularin e tenderit ashtu siç duhet ku është kërkuar te plotësohet rubrika e nenkritereve,2.Te kërkesa e përshtatshmërisë profesionale ne piken 3 është kërkuar Certifikatat ISO, Ju keni dorëzuar Certifikatat ku disa prej tyre janë me afat te skaduar date 25.10.2023 do te thotë pa afat. Me datën 03.01.2024 brenda afatit ligjor ne kemi kërkuar Rishqyrtim te vendimit te datës 29.12.2023 me pretendimin se AK ka bere shkelje ligjore lidhur me eliminimin e kompanisë tone pikërisht NEN-et 1,6,7,59,72 te LPP-se: Pretendimi ynë Lidhur me formularin e Ofertës ka qene: Sa i parkete nen kritereve te plotësuara me zero për garancionin e pajisjes; ne kemi plotësuar deklaratën mbi garancionin ku kemi dhënë 2 vite garancion për te gjithë artikujt e ofruar për te cilën ishte vendosur nen kriteri ne baze te asaj deklarate AK shume lehte ka mundur te beje vlerësimin e ofertës. Po ashtu e njëjta ka ndodhur tek nen kriteri për afatin e liferimit, ne kemi plotësuar deklaratën mbi liferimin e mallit ku kemi dhënë afatin 10 dite për te gjithë artikujt dhe AK ka mundur te beje vlerësimin e ofertës, sepse ekzistojnë te gjitha te dhënat për tri nen kriteret e kërkuara: Çmimi, deklarata për garancion 2 vite, deklarata për Liferimin e mallit 10 dite. Pretendimi ynë lidhur Certifikatat ISO ka qene se. Ne posedojmë ato certifikata me afat mirëpo gjate ngarkimit ne sistem është bere gabim teknike. Ne i kemi bashkangjitur certifikatat me afat ne kërkesën për rishqyrtim te datës 03.01.2024. dhe AK ka pasur mundësinë për te kërkuar plotësim te dokumentacionit ne baze Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtese. dhe ne baze te udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik. "Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik - Mungon certifikata ISO- Mund të kërkohen informata sqaruese-69" .Me datën 04.01.2023 ne një afat rekord ka marrur vendim për Refuzim te kërkesës ku AK njëkohësisht ne ora 10:28 ka dërguar vendimin për pezullim dhe vendimin për Rishqyrtim. Me rastin e vendimit për Rishqyrtim AK ka refuzuar kërkesën për Rishqyrtim duke mos e arsyetuar ne asnjë mënyrë vetëm ka bere përshkrim te vendimit te datës 29.12.2023 e qe bëjnë ne kundërshtim me ligjin mbi prokurimin publik duke mos arsyetuar vendimin lidhur pretendimet tone te cekura me lart".

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "Agri Bau Sh.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 72 LPP-së si dhe Udhëzuesi Nr.001/2023 për Prokurimin Publik . Pas gjitha këtyre fakteve te ofruara shpresojmë dhe besojmë se Organi Shqyrtues i Prokurimit do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tone dhe do ta aprovoj si te bazuar këtë ankese duke marre: Vendim Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Agribau" SHPK kundër Vendimit te AK-se date 04.01.2024 për Refuzim te kërkesës për Rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi Sh. A. nr. prokurimi #NPLP-23-13818-l-2-l. Anulohet njoftimi mbi Vendimin e AK-se datës 29.12.2023 dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim me qellim te marrjes se një vendimi ne përputhje me Ligjin mbi Prokurimin Publik."

-Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues-

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke respektuar nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik në zbatim të respektimit të parimit të ligjshmërisë, jo-diskriminimit dhe parimit të konkurrencës së lirë. Po ashtu Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke zbatuar nenin 59 të LPP-së,

dispozitat të Rregullores për Prokurimin Publik si dhe kriteret e dosjes së tenderit. Baza ligjore për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është si në vijim: X Nuk keni plotësuar kërkesat administrative X nuk i keni plotësuar kërkesat par përshtatshmëri profesionale .Kërkesa e juaj për pjesëmarrje është teknikisht e papërgjegjshme: Arsyetim: Nuk keni plotësuar formularin e tenderit ashtu siç duhet. Ne aneksin 6 te dosjes se tenderit kriter për dhënie te kontratës ka qenë 0. Tenderi ekonomikisht më i favorshëm ku ka qen edhe ne tabela: Ju nuk keni plotësuar formularin e tenderit siç duhet, ne kolonën përgjigjet OE ne te tri pozicionet keni vendosur shifrën 0 (zero). Te kërkesat për përshtatshmëri profesionale pika 7,1 &7,2 ne piken 3 është kërkuar qe: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të dorëzoj Certifikatat ISO Standarde që lidhen me natyrën e aktivitetit a) Certifikata ISO Standard ISO 9001 2015 (sistemi i kualitetit te menaxhimit) b) Certifikata ISO Standard ISO 45001 2018 (menaxhimi i sistemit të sigurisë dhe shëndetit ne pune) c) Certifikata ISO. Standard ISO 14001 2015 (Sistemi i menaxhimit mjedisor) d) Certifikata ISO Standard ISO 39001 2012(sistemi menaxhimin e logjistikes rrugore- për aktivitetet kultivimin e luleve dhe fidanëve rrënjore). Ju keni dorëzuar certifikatat ISO 9001-2015 me vlefshmëri vetëm deri ne 25.10.2023, certifikatën 14001-2015 me vlefshmëri vetëm deri me 25.10.2023. Certifikatën 45001-2018 me vlefshmëri deri me 25.10.2023 qe do të thotë se të gjitha këto certifikata. ISO janë me afate skaduara. Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur."

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16.01.2024 ka autorizuar eksperten për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 39/2024, ndërsa me datë 29.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/39 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit, ndërsa OE nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE "Agri Bau Sh.P.K." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/39, në vijim-

Konstatimi i parë (I): "Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 39/24 ka të bëjë me arsyen e parë të eliminimit, ku sipas AK-së OE ankues ka ofruar ISO certifikatë me afat të skaduar. OE ankues pretendon se AK në pajtim me dispozitat ligjore ka mund të kërkoj sqarime shtesë, dhe po ashtu ofron si dëshmi certifikatën ISO me afat valid. Në cilësi të ekspertit shqyrtues pas analizimit të certifikatës me afat valid, përmes faqes zyrtare të certifikuesit SISTEMA, dhe përmes numrit të certifikatës "AGS/2311/QSCIPL-KOS-Q5368", kemi gjetur se i njëjti OE ka certifikatë me afat valid. Vlerësojmë se një sqarim i tillë nuk përbën ndryshim material të ofertës, pasi kemi të bëjmë me njëjtin operator ekonomik, njëjtin certifikues dhe njëjtat standarde për të cilat është certifikuar OE në fjalë, dhe në pajtim me dispozitat e LPP-së në mënyrë objektive përmes faqes së certifikuesit mund të verifikohet ekzistenca e dokumentit para afatit të fundit për dorëzim të tenderit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar."

Konstatimi i dytë (II): "Pretendimi tjetër ankimorë sipas ankesës 39/24 ka të bëjë me arsyen e dytë të eliminimit, ku sipas AK-së OE ankues nuk e ka plotësuar formularin për dorëzimin e tenderit si duhet, duke mos plotësuar rubrikat e nën kritereve. Pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe ofertës së OE ankues, kemi gjetur se i njëjti nuk i ka plotësuar rubrikat e nen kritereve, ku nuk e përcaktuar periudhën për garancionin e performancës, si dhe nuk ka përcaktuar afatin e liferimit. OE ankues pretendon se ky gabim teknik ka ndodhur për shkak të kohës së shkurtë për përgatitjen e ofertës. Në cilësi të ekspertit shqyrtues vlerësojmë se një "gabim teknik" i tillë e bënë të pamundur vlerësimin gjegjësisht poentimin e ofertës së OE ankues pasi nuk dihet a ka ofruar minimumin apo maksimumin e garancionit dhe liferimit. Përveç

kësaj sipas udhëzuesit operativ për prokurimi publik neni 10.1, shprehimisht e ndalon të kërkohen sqarime në rast se formulari I tenderit nuk është plotësuar si duhet. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Agri Bau Sh.P.K." Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Agri Bau Sh.P.K." janë pjesërisht të bazuara, por që nuk ndikojnë në ndryshimin e vendimit të autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërkaq vendimi i AK-së duhet të mbetet në fuqi, pasiqë pretendimet e Ankuesit nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të rivlerësohet.

Paneli shqyrtues konform raportit me rekomandime të ekspertit shqyrtues sqaron se është i qëndrueshëm arsyeja e eliminimit të OE ankues për faktin se OE ankues nuk e ka plotësuar formularin për dorëzimin e tenderit si duhet, duke mos plotësuar rubrikat e nën kritereve. OE ankues po ashtu nuk e përcaktuar

periudhën për garancionin e performancës, si dhe nuk ka përcaktuar afatin e liferimit. Paneli shqyrtues në mes tjerash thekson faktin se kjo e bënë të pamundur vlerësimin gjegjësisht poentimin e ofertës së OE ankues pasi nuk dihet a ka ofruar minimumin apo maksimumin e garancionit dhe liferimit. Përveç kësaj sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik neni 10.1, shprehimisht e ndalon të kërkohen sqarime në rast se formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e raportit të ekspertit shqyrtues dhe dokumentet DT, konstaton se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi sh.a." me nr. të prokurimit: "NPLP-23-13818-1-2-1".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të përsëritshëm të ankesës të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.**
- OE - **AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: